



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:202495
Datë: 27.02.2025
Numri i dokumentit: 06911122

CA.nr.2677/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Ylber Shurdhiqi dhe Malsor Kryeziu, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses A.K. nga fshati R., Komuna e D., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.Sh., avokat në P., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e diferencës në pagë mbi bazën e licencimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.720/2021 të datës 05.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.02.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Deçanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.720/2021 i datës 05.02.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.720/2021 të datës 05.02.2024, ka vendosur si në vijim:

“I. APROVOHET e bazuar në ligj kërkesëpadia e paditëses A.K. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses në emër të pagesës për diferencë në pagë për shkak të licencimit, për periudhën 19.07.2018 e deri më datën 06.02.2023, apo për 54 muaj dhe atë për kualifikim me diplomë universitare në vlerë prej 27% nga paga bazë, për secilin muaj veç e veç t’i paguaj shumën prej 55,35 €, apo shumën e përgjithshme prej 2.988,90 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 10.07.2021 (data e paraqitjes

së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 248,00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit ligjor.“

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën, dhe të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje të sërishme apo që Gjykata e Apelit në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës të vendosë vet në mënyrë meritore.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, duke kërkuar që të obligohet e paditura në kompensimin mbi bazën e kualifikimit, me arsyet sikurse në padi, e po ashtu duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, pas marrjes së përgjigjes në padi dhe vlerësimit të provave dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.720/2021 të datës 05.02.2024, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se themelësia e kërkesëpadiisë del nga shkresat e lëndës që i janë bashkangjitur padisë, nga të cilat gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar që nga data 01.09.2014 dhe atë mësimdhënëse e Mësimi Klakor, në Sh.F.M.U. “Rexhep Kadrijaj”, në fshatin Rastavicë, Komuna e Deçanit, e njëjta ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë dhe ka marr titullin “Bachelor i Programit Fillor”, po ashtu posedon licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 1022448. Paga bazë e paditëses është 421 euro dhe në emër të licencës për çdo muaj i është paguar shuma prej 58,32 euro. Tutje ka theksuar se paditëses i takon e drejta e kompensimit të të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 19.07.2018 e deri me datë 06.02.2023 apo për 54 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 55,35 euro për çdo muaj, apo shuma e përgjithshme prej 2.988,90 euro, për këtë kriter të kompensimit. Bazën ligjore për vendosje e ka mbështetur në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008. Vendimin mbi kamatën e ka bazuar në

nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur në bazë të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë edhe pretendimet tjera të palës ankuese të cekura në ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës, kualifikimi dhe licencimi i paditëses.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se e njëjta me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë, me të drejtë është bazuar në Vendimin e Qeverisë, Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri më datë 06.02.2023 (i shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, Nr.08/L-196), është përcaktuar se të gjithë mësimmshënësit do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit, pra mësimmshënësve, drejtorëve, zëvendësdrejtorëve dhe bashkëpunorëve profesional, përfitojnë rritje page me diplomë të shkollës normale 10 % të pagës bazë, me diplomë të shkollës pedagogjike me nje ngritje te pagës bazë prej 19%, me diplome universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35 %. Se një e drejtë e tillë i takon palës paditëse, e ka sqaruar edhe Gjykata Supreme e Kosovës në mendimin juridik Gj.A.nr.214/2023, datë 09.10.2023.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për kompensimin në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit për punonjësit me licencë, ka bërë konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përputhje me provat e bashkangjitura shkresave të lëndës ka vërtetuar faktin se paditësi ka kualifikim bachelor, paga bazë e të njëjtës është 421.00 euro, dhe se në emër të kualifikimit i është paguar në baza mujore shuma prej 58.32 euro.

Njëherazi, gjykata i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës, se nuk është paraparë me Ligjin e Punës apo se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, ngase i

njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet "Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit".

Kjo Gjykatë pati parasysh edhe pretendimet lidhur me parashkrimin e kërkesës, por vlerëson se as ky pretendim nuk qëndron pasi që paditëset kërkesën e tyre e kanë parashtruar brenda periudhës kohore 3 vjeçare të përcaktuar me Ligjin e Punës, më konkretisht me nenin 87 ku përcaktohet se: *"Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës"*, sepse kemi të bëjmë me kërkesa nga marrëdhënia e punës e të cilat kërkesa janë të rregulluara me Ligjin e Punës, i cili zbatohet në kontestet e kësaj natyre, andaj vie në shprehje afati 3 vjeçar i parashkrimit, e i cili në rastin konkret nuk ka arritur sepse paditësja e ka parashtruar kërkesën e saj brenda afatit të përcaktuar me ligj.

Lidhur me pretendimet ankimore përkitazi me nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka nxjerrë të njëjtin pasi që janë përmbushur në tërësi të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 150 të LPK-së.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së dhe tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.2677/2024, datë 25.02.2025

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj d.v